

AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“CARGO TRANS TIRANE” SHPK

Sot, më 11/08/2020 asambleja e ortakeve te shoqerise me:Z. RIZA SHEHU i biri i Ahrrtit lindur ne Fier më 25 Janar 1989 banues ne Tirane “Rruga Dajti”, Pallati Romir , kati 2 hyrja nr.2 Tirane, identikuar nepermjete kartes se identiteti me nr. I90125025P, shtetas Shqiptare madhere dhe me zotesi te plotë per te vepruar.

Me vullnetin e lire dhe te plotë asambleja e ortakeve te shoqerise bazuar ne legjislacionin shqiptare:

- “Kushtetuta e Republikës se Shqipërisë”;
- “Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”;
- “Ligji Nr. 9723 dt. 03/05/2007 “Për Qëndren Kombëtare te Rregjistrimit ”;
- “Kodi Civil I Republikës se Shqipërisë ”;

-Si dhe bazuar ne Legjislacionin ne fuqi ne Republikën e Shqipërisë U hartua ky statut I shoqerise tregtarë “**CARGO TRANS TIRANE**” SHPK e cila ka formën e një shoqërie me pergjegjësi të kufizuar, shpk ,e cila do te funksionojo ne përputhje me ligjin Shqiptar dhe ne përputhje me statutin vendosen si me poshtë:

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1:

Emertimi I Shoqersie

Kam vendosur krijimin e një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “**CARGO TRANS TIRANE**” SHPK me poshte e quajtur edhe “Shoqëria”.

Neni 2:

Selia e Shoqerise

Selia e shoqërisë “ **CARGO TRANS TIRANE** ” Shpk ndodhet ne adresën: Tirane, Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga “Frederik Shiroka”, Godina Nr.1, Kati Përdhe, Zyra Nr.25.

Riza Shehu

Neni 3:

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë " CARGO TRANS TIRANE "Shpk do të jetë per një periudhe te pacaktuar ,duke filluar nga moment i rregjistrimit ne QKB ,Tirane

Neni 4:

Objekti I aktiviteti:

Shoqeria ka per objekt : "Transport i per gjithshem mallrash dhe udhetarcash, urban dhe interurban, kombetar dhe nderkombetar per vete dhe per te trete.Tregtim makinerie e pajisje automjete te ndryshme si dhe pjesa kembimi. Pjesmarrje ne tendera te ndryshme , panaire, si dhe gjetja e tregjeve te pershtatshme per tregimin e prodhimeve te shoqerise, Brenda dhe jashte vendit. Import export, shitblerje me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem ushqimore dhe industrial.Tregtim artikujsh te ndryshme Industriale. Tregtim artikujsh te ndryshem ushqimor.Tregtim konfeksione te llojeve te ndryshme. Servis e mirembajtje makinash, lavazh, bar bufe. Tregtim pajisje elektroshtepijke, elektronike, elektrike,kompjuterike, higjenosanitarie, hidraulike, pajisje zyrash, prodhime qeramike, duhan dhe cigare. Tregtim prodhimesh te ndryshme druri, lende ndertimi. Investime ne fushen e ndertimeve dhe industrise ushqimore. Suvatime, patinime, punime gipsi, lyerje. Blerje, shitje, dhenie me qera, te pasurive te luajtshme dhe te pa luajtshme. Lidhja e kontatave me persona juridike dhe fizike, brenda dhe jasht vendit,kontrata keto qe kane lidhje me objektin e vepritarise se shoqerise. Çdo lloj vepritarie tjeter te lidhur me pikat e permendura me lart te cilat jane te lejuara me ligj".

Aktiviteti do te ushtrohet ne perputhje me ligjet dhe aktet nenligjore ne fuqi te cilat rregullojnë kete fushe .

Neni 5:

Shoqeria mund te ndryshojet emertimin ,seline,kohezgjatjen dhe objektin e vepritarise se saj sipas vendimeve qe do marr ortaku i vetem.

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100 000 (nje qind mijë) leke i perbere nga 1 (një) kuotë, te zotëruara 100 % nga Z. RIZA SHEHU, Ortak i Vetem.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)



Neni 7:

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogelimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Kuotat e kapitalit janë emrore dhe te transferueshme.

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimmarres


Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.



Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përsaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 10

Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nësc parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 11

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nësc asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorimit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

Neni 12

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vodos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vodos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 13

Përjashtimi nga e drejta e votës

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngrijen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënen ose jo të përfitimeve të reja.

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Zan Ghehu
J

Neni 14

Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.


(3) Z. RIZA SHEHU i biri i Ahmitit lindur ne Fier me 25 Janar 1989 banues ne Tirane "Rruja Dajti", Pallati Romir, kati 2 hyrja nr.2 Tirane, identifikuar nepermjete kartes se identitetit me nr. 190125025P, caktohet si Administratore i pare i shoqerise.

Neni 15

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen përmbytjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ccurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përmbytjeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblecë së përgjithshme përmiratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojnë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë përmiratuarë së shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.



Administratoret janc te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 16

Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale osc solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

Zana Shala

(B)

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare“, kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte astësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërbimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Ziua 19.06.2018

Viti finanziar-ekspertet

Neni 17

Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllte me 31 Dhjetor.

Neni 18

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithvektor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gjc te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar perqatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.


Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 19

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- ç) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshtë njoftuar pezullimi i veprimtarise ne përputhje me pikën 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- d) me vendim te gjykates;



The image shows two handwritten signatures in black ink. The top signature appears to be 'Ruzica Osheliu'. Below it is another signature, which is partially obscured by a large, stylized 'J' shape.

Në kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 20

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vcdnimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 21

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtarc", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 22

Mosmarrëveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptar.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE:

" CARGO TRANS TIRANE "SHPK

RIZA SHEHU

